

ASTRIT KARADAKU

ROMAN



MAGJI
STARI I
NATES



8SH-31
K31

ASTRIT KARADAKU


MAGJISTARI

I

NATES

ROMAN

1



SHTEPIA BOTUESE "GLOB"

1994

**KOHA QE LAME ISHTE
GROTESKE DHE HISPERBOLE,
PRANDAJ DHE ROMANI NE
FJALE E TRAJTONATE NE NJE
OPTIKE TE TILLE. SI NE ÇDO
VEPER LETRARE, NGJARJET
DHE PERSONAZHET E KETIJ
ROMANI JANE NJE TRILLIM
ARTISTIK DHE PRA EDHE
KRAHASIME ME NGJARJE
OSE PERSONAZHE REALE
NUK KA PSE TE BEHEN.**

Autori

Salla dhe presidiumi dukej sikur kishin ngrirë, të kapur nga një makth i madh. Oratori në podium ishte sekretari i parë, Hasan Hyseni, figura qendrore e partisë prej gati 50 vjet. Nën afshin e fjalimit fytyra, zakonisht e verdhë, si e një të sëmuri që kishte vite në spital, i ishte skuqur pakëz dhe në ballë iu shfaqën bulëza djerse. E shoqja, Naileja, që rrinte në rradhën e parë, bashkë me sekretaren e parë të rrethit të Myzeqit, Naqen, kalonte nga një gjendje entuziazmi dhe merak. Që nga 1972 kur i shoqi kishte kaluar një ishemi, ajo dridhej nga mendimi se kriza e rëndë që kishte kaluar mund të përsëritej përsëri. Kjo do të ishte një goditje e tmerrshme për të, vendin dhe gjithë komunizmin. Se tashmë ai i përkiste gjithë komunizmit ndërkombëtar mendonte ajo nën valën e entuziazmit. Padashur

i ndërpreu mendimet.

- Partia do të godas fort armiqtë e diktaturës së proletariatit, ata që i shërbejnë imperializmit dhe revizionizmit.

Salla e madhe e mbledhjeve të KQ, me dritaret nga parku i madh, tërë dritë, atë çast duket se shpërtheu. Ovacioni e përshkonte sallën, përfshirë dhe aëtarët e byrosë që rrinin në presidium. Në mes duartrokiste si i deprimuar kryetari i qeverisë, Mahmuti, një njeri që kishte namin e një arroganti dhe të një diktatori. Megjithatë edhe ai tashmë po mendonte me frikë rreth fjalëve që sapo kishin dalë nga goja e shokut Hasan. "Vallë kush do ta pësonte kësaj radhe?" po pyeste ai veten. Mos vallë ai? Atë çast salla brohoriti dhe thërriti me entuziazëm të madh - Parti - Hasan, për ty jemi të tërë në këmbë! Bashkë me ta thërriste dhe ai, i kapur nga ajo vala që e kiste jetuar shumë herë në këtë sallë dhe jashtë saj. Tani ajo që sapo kishte menduar iu duk më absurde se kurrë. Hasani e kishte thirrur prej një muaji në selinë e KQ. Ai donte t'i jepte vendin e sekretarit që sapo kishte vdekur në mënyrë të papritur në Pari, ku kishte shkuar për kurim. E ardhmja e tij po thonte Mahmuti dukej

sikur ishte e sigurtë dhe ai kishte përgatitur një raport të rëndësishëm për çështjen e tufëzimit. E megjithatë ai nuk mund të harronte se çfarë i thonte e shoqja - Mahmut kujdes! Çfarë parandjente ajo? A mund të ishte ajo në gjendje të parashikonte diçka? A kishte të drejtë? Atë çast ndjeu nevojën të dilte jashtë kësaj salle, të ikte diku në gjuetinë e tij të preferuar të dërrit të egër, në mes të pyjeve, ku e ndjente veten të qetë, zot dhe perëndi. Aty nuk mund t'ia kalonte Hasani, meiti, sikur e quate ai me vete. Ishte radha e tij të ishte i pari. Po këto ishin mendimet e tij të fshehta, subkoshienca e tij, që Hasani nuk mund ta zbulonte. A mund ta dijë ai këtë? pyeti veten me frikë. Sikur ta dinte për të, dënimi ishte i qartë.

- Partia do të forcojë udhëheqjen e saj duke futur shoqe e shokë të rinj nga radhët e klasës punëtore, besnikë të çështjes së saj!

Pas këtyre fjalëve të Hasanit, salla u ngrit në këmbë dhe brohoriste pa prerë. Hasani duartrokiste bashkë me të tjerët dhe mendonte edhe një herë se tashmë kishte bërë diçka në kohën dhe në vendin e duhur për vazhdimësinë e veprës së tij. Ai i mallëngjyer dhe vetë, ua bëri

me dorë dhe salla sikur iu bind me zor.

Pastaj ai shpalli emrat e anëtarëve dhe kandidatëve të rinj të byrosë. Mes tyre ishin një çoban që ishte sekretar i parë në Sheleg, myzeqarja që rrinte në radhën e parë bashkë me Nailen, që po e përqafonte e mallëngjyer, një burrë i shkurtër që kishte qenë saldator dhe tani ishte sekretar i parë në një rreth jugor, një sharrëtar, që ishte gjithashtu sekretar në një rreth të vogël verior, si dhe funksionari i partisë, Spiroja. Të gjithë ata ishin vënë tashmë në qendër të vëmendjes dhe për këtë Hasani propozoi një gjysëm ore pushim.

Salla po boshatisej ngadalë dhe zhurma si zukama e një foleje grerëzash u çvendos nëpër shkallët dhe koridoret e KQ. Anëtarët dhe kandidatët e rinj u ftuan nga atjutantët e tyre të sapoemëruar që të shkonin në sallën e posaçme të byrosë, ku ishin tashmë Hasani me shokët e tjerë. Të vjetrit dhe të rinjtë u puthën me njeri-tjetrin të mallëngjyer dhe ngritën gotat me raki për urim. Hasani foli: - Tani u shtuam shokë, u bëmë më të fortë.

- Ashtu, ashtu - thanë të tjerët dhe çokën gotat. Burri i shkurtër, me një fytyrë të zezë që vinte një farë dyshimi për origjinën e tij, foli me

një zë të ngjirur, si të një marioneteje. - Ju faleminderit shoku Hasan dhe ju shokë për nderin e madh. Ne do të luftojmë me të gjitha forcat për të mbrojtur çeshtjen e partisë, do të jemi përkrah shokut Hasan gjithnjë.

Hasani i mallëngjyer, e ftoi të shkonte pranë tij dhe e puthi në të dy faqet. Burri i shkurtër, filloj të qajë me dënesë.

- Ç'bën kështu shoku Lefen - i tha Hasani.

- Shoku Hasan na keni bërë nder të madh dhe këtë nuk do ta harrojmë kurrë - tha Lefeni.

Këtë skenë të tjerët po e ndiqnin të prekur. Vetëm Mahmuti sikur u step pakëz. Ai mendoi se ky saldator ndofta do të ishte një kundërshtar i tij për fronin. Ai e dinte se Hasani ishte nga natyra shumë kapriçioz, dhe në se ky punëtor e kishte menduar këtë skenë më parë, ai padyshim ia kishte arritur qëllimit.

- Për të tillë shokë ka nevojë partia në këto çaste - tha Hasani.

Të mësuar me gjëra të tilla të ngjajshme më parë, ata që ishin më të vjetër dhe që e njihnin Hasanin nga afër, menduan se ky ish-saldator me fytyrë jevgu do të ishte ndër më të favorizuarit në të ardhmen. Sekretari i propagandës, nie fytyrë të

zbehtë, të rrumbullaktë bëri një nënqeshje të lehtë, ndërsa nënkryetari i qeverisë një burrë kokoroc, buzëqeshi me gjithë zemër. Në sallë zotëronte një atmosferë idolatrie. Vetëm Mahmuti ndjente një hakërrim të brendshëm kundër jevgut, siç kishte filluar ta quante ai. Loja po bëhet më e ndërlikuar tha ai me vete. Nuk e dinte në do t'ia dilte të arrinte në krye fare. Atë çast sikur po e linte zemra dhe një zë i brendshëm po i thonte se nuk do të fitonte kurrë. Ai kurrë nuk do t'ia zinte vendin Hasanit, kurrë. Depresioni, që kishte filluar ta pushtonte kohët e fundit u shfaq në fytyrën e tij në formë ngerçi. Ai donte të ikte në këtë çast nga kjo sallë, që po i rëndonte si një makth. Çfarë po ndodhte me të? Çfarë rrengu po i lozte fati? Mos vallë do të zhdukej nga skena, siç ishte zhdukur sekretari, të cilit ai i kishte zënë vendin? Një rrënjqethje tmerri ia përshkoi qenjen. Vështroi Hasanin që tashmë po bisedonte me kooperativisten, një grua e trashë, me flokët e thinjur. Ishte e qartë, koha e tij kishte shkuar. Këta punëtorë do të zinin këtej e tutje vendet kryesore. Koha e tij kishte perënduar vallë?

Ajo pasdite e bukur e Tiranës po kridhej nën zbehtësinë e mbrëmjes. Pishat e mëdha sikur

ndjenin këtë afrim dhe mblidheshin në vetvete. Edhe pemët dhe njerëzit kishin mekanizmat e tyre biologjike të ngjajshme. Tani në bulevard po derdheshin valët e njerëzve, që nxitonin të linin në asfalt lodhjen e ditës. Kurse për te kjo lodhje nuk do të largohej kurrë. Do të ishte mirë që të dilte nga kjo sallë, ku tashmë të zihej fryma. Po e mbajti veten. Ai e dinte se ndoshta dhe të tjerë në këtë sallë kishin mendime të ngjajshme me të. Po asnjëri nuk do të hapej, sepse kjo do të ishte njësoj sikur të nënshkruante dënimin e tij me vdekje. Çfarë thoshte vallë Delfini, po mendonte ai për sekretarin e propagandës, që e kishte gëzuar me një shkrim që kishte bërë për veprën e tij të parë. A thua e kam aleat? po mendonte. Asgjë s'mund të dihej, po ai e dinte se këtë reaksion si të tijin e ndjenin dhe të tjerë. Ishte një komedi e madhe, që po luhej në kurriz të tyre. Ishte diçka absurde. E dinte se arkitekti i saj ishte vetë Hasani, që ndërronte kështu ballancën e forcave në favor të tij. Sigurisht të gjashtë të rinjt do t'i hidheshin në grykë kujtdo për Hasanin, meiti kishte fituar si gjithnjë. Si gjithnjë mendoi ai me vete, duke nisur që nga koha e luftës. Ai kish shkelur mbi kufoma për të ruajtur fronin e tij